



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës** bënë:

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Konsulentë individualë vendorë për të kryer intervistat për Anketën TIK (ICT)
Numri i referencës:	IPA 2015; Commission Regulation (EU) 2017/1515
Tarifa e shërbimit:	Sipas marrëveshjes
Raporton te:	Mbikëqyrësit/ASK
Lloji I kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Deri ne dy muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i intervistuesve:	ASK-5

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative përfshi Pyetësorin e ekonomisë familjare, dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën e përdorimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit - TIK (ICT);
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e TIK (ICT) me metodologjinë PAPI (Letër dhe Laps).
- Të bëjnë identifikimin e ekonomisë familjare duke u bazuar në Listat e ekonomive familjare dhe në harta si dhe të respektohet kriteri për individë për moshën 16 deri 74 vjeç;
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që nuk duhet t'i parashtrijnë disa të anketuarve dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia familjare bene kontrollimin e pyetësorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Rishqyrtimi për të intervistuar ekonomitë familjare të cilat nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Përdorimi i adresave dhe hartave për qarqet regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flasin ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin javor te mbikëqyrësi;
- Të përfundojë Anketa e Ekonomive Familjare dhe Individëve brenda afatit të përcaktuar;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar;
- Të kthejë materialet dhe pajisjet e pranuar nga ASK (hartat dhe Listat e ekonomive familjare), pas përfundimit të punës në teren.

Përgatitja shkollore:

- Të ketë shkollën e mesme të përfunduar;
- Përvojë pune në anketime (e preferueshme);

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet anketa TIK (ICT).

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK

Bazuar në mostrën e përzgjedhur (numri i ekonomive familjare që duhet intervistuar dhe numri të anketuesëve) te anketa TIK-ut sipas regjioneve dhe etnitetit është paraqitur në tabelë.

Regjioni	Anketues shqiptarë		Anketues serb	
	Nr. ekonomive familjare	Nr. i anketueseve	Nr. ekonomive familjare	Nr. i anketueseve
Prishtinë	500	2 anketues	45	1 anketues
Gjilan dhe Ferizaj			35	1 anketues
Gjakovë	200	1 anketues		

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-se, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-qov.net/> Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr,"Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, diploma për shkollën e mesme të kryer (te gjitha dokumentet duhet të jene kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 151 prej orës 08:00 – 16: 00.

¹ Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike

